



Lajmet e Fundit:

Berat – Aksidenti dy shtetase, njërën prej tyre me pasojë vdekjen, identifikohet dhe arrestohet drejtuesi i motomjetit



Lajmet

21/03/2022

Tiranë – Falë ndërhyrjes në kohë nga Policia, parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i një konflikti me armë zjarri

Vihen në pranga 3 shtetas, mes tyre një 60-vjeçar që tentoi të vriste me armë zjarri një tjetër. Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, pas marrjes së njoftimit për një konflikt me armë në Kombinat, në rrugën “Llambi Bonata”, menjëherë kanë organizuar punën dhe bënë arrestimin në flagrancë të shtetasve: – A. Sh., 60 vjeç, për veprat penale “Vrasja me dashje” mbetur në tentativë, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”; – E. G., 27 vjeç dhe M. G., 42 vjeç, për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”, kryer në bashkëpunim. Shtetasi A. Sh., gjatë një konflikti për motive të dobëta me shtetasin E. G., ka tentuar ta vrasë me armë zjarri. Më pas shtetasi E. G., së bashku me shtetasin M. G., kanë goditur shtetasin A. Sh. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua një armë zjarri pistoletë, një krëhër me municion luftarak, gëzhoja dhe një automjet në pronësi të shtetasit A. Sh. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme.

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Tiranë – Viojnë kontrollet e dedikuara nga Policia Rrugore e Tiranës me qëllim evidentimin dhe ndëshkimin e shkelësve të Kodit Rrugor

Tiranë – Vijon operacioni policor i koduar “Fati i lojërave” ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)